

# ANALIZË MBI QEVERISJEN E HAPUR TË **ZYRËS SË KRYEMINISTRIT** NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

PROPOZIME PËR PËRMIRËSIMIN  
E GJENDJES AKTUALE

## **RRETH PUBLIKIMIT**

*Ky dokument është zhvilluar në kuadër të projektit 'Boost Good Governance 2.0', i mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED), dhe i zbatuar nga Open Data Kosovo (ODK).*

### **AUTORËT**

Dafina Olluri dhe Delvina Haxhijaha

### **VERSIONET GJUHËSORE**

ALB, ENG, SRB

*Përfunduar në Shkurt, 2022 © ODK*

*Mendimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi vetëm e autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të NED. Riprodhimi dhe përkthimi për qëllime jo komerciale janë të autorizuar, me kusht që të njihet burimi dhe botuesi të njoftohet paraprakisht dhe t'i dërgohet një kopje.*

## HYRJE

Analizat e zhvilluara nga Open Data Kosovo (ODK) përgjatë viteve të cilat kanë monitoruar dhe vlerësuar hapjen dhe transparencën e Institucioneve në Kosovë, shpalosin qartazi se transparenca legislative mund të përmirësojë performancën e zyrtareve publik në demokraci. Në një demokraci, nxitja për përmirësimin e performancës krijohet nga komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me qytetarët. Ky dokument ju drejtohet vendimmarrësve në institucionin kryesor të pushtetit ekzekutiv në të gjitha nivelet: në Qeveri dhe në ministri, megjithatë, ai reflekton vetëm gjetjet nga pushteti kryesor ekzekutiv, përkatësisht Zyra e Kryeministrit. Vendimmarrës të tillë mund të përfitojnë nga ky dokument nëse rezultatet dhe rekomandimet e tij merren me kujdes në konsideratë. Punimi mund të jetë në dobi të përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare, si dhe kolegëve nga sektori i OJQ-ve që merren me këto çështje.

Duke përdorur praktikën e Analizës së zhvilluar për Zyrën e Kryeministrit përgjatë matjes paraprake të vitit 2019, analiza e propozimit të politikave praktike edhe kësaj here është rezultat i një hulumtimi të gjerë të bazuar në metodologjinë shkencore të kryer nga Open Data Kosovo në muajt e fundit. Qëllimi i këtij hulumtimi gjithpërfshirës është të sigurojë një pasqyrë të detajuar të situatës në Kosovë dhe të kontribuojë në zbatimin e reformës së administratës publike. Ky punim gjithashtu synon të forcojë parimet e qeverisjes së mirë dhe të ndihmojë institucionet t'i zbatojnë ato në mënyrë më efektive në punën e tyre.

Pra, pas një vlerësimi të qëllimit të propozuar në vitin e kaluar, respektivisht në 2019, ky punim paraqet analizën e nivelit të hapjes dhe rekomandimet për përmirësim për vitin 2020. Metodologjia dhe treguesit e saj janë përmirësuar vazhdimisht dhe i janë përshtatur kërkesave të vitit përkatës. ***Ky dokument i politikave sjell gjithashtu një element krahasues ku ODK-ja ka hartuar një analizë duke përfshirë progresin e treguar përgjatë dy viteve të fundit.***

Hapja institucionale duhet të jetë politika e të gjitha qeverive në rajon dhe duhet të formulohet dhe trajtohet në mënyrë të barabartë si politikat e tjera të rëndësishme. Një politikë e tillë duhet të ruajë objektivitetin e saj në këtë çështje dhe nuk duhet të ndikohet në asnjë rast nga vendimet aktuale politike ose elemente tjera politike.

ODK-ja ka respektuar parimet e transparencës së hulumtimit dhe ka prezantuar tek institucionet të gjitha detajet dhe rezultatet e tij. ODK-ja mbetet e hapur për çdo sugjerim, kritikë konstruktive dhe diskutim në lidhje me dokumentin e politikave.

## METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Kjo analizë përcolli shkallën e marrjes së informacioneve nga Indeksi Rajonal i Hapjes i cili mat se deri në çfarë mase janë institucionet e vendeve të Ballkanit Perëndimor të hapura për qytetarët dhe shoqërinë dhe bazohet në katër parimet e mëposhtme:

🔍 **transparenca,**

🗨️ **qasshmëria,**

🤝 **integriteti dhe**

🔧 **ndërgjegjësimi.**

Duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet dhe shembujt e praktikave të mira, këto parime zhvillohen më tej përmes treguesve specifik, sasiorë dhe cilësorë. Parimet e tilla vlerësohen në bazë të: qasjes së informacionit në faqet zyrtare të institucioneve, cilësisë së kornizës ligjore për pyetje specifike, burimeve të tjera të informacionit publik dhe pyetësorëve të dorëzuar në institucione. Mbledhja e të dhënave ndoqi një model verifikimi të të dhënave i cili rezultoi në gabimin standard prej +/- 3%. Matja u krye në periudhën nga muaji maj 2021 deri në fund të muajit tetor 2021. Një grup rekomandimesh drejtuar institucioneve u zhvillua në bazë të rezultateve të hulumtimit.

Parimi i **transparencës** kërkon që informacioni organizativ, buxheti dhe procedura e prokurimeve publike të jenë në dispozicion të publikut dhe të publikohen dhe përditësohen rregullisht. **Qasshmëria** lidhet me sigurimin dhe respektimin e procedurave për një qasje të lirë në informacion, përmirësimin e disponueshmërisë së informacionit përmes debateve publike dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët. **Integriteti** përfshin elementet e parandalimit të korrupsionit, kryerjen e kodit të etikës dhe rregullimin e lobimit. Parimi i fundit, **ndërgjegjësimi**, i referohet monitorimit dhe vlerësimit të politikave të kryera nga institucionet.

Disponueshmëria e informacionit mbi politikat dhe veprimet e qeverisë, një ndjenjë e qartë e përgjegjësisë organizative dhe një siguri se qeveritë administrohen në mënyrë efikase dhe pa korrupsion sistemik, janë komponente të rëndësishme të qeverisjes transparente. Andaj, edhe të gjitha katër principet e lartpërmendura si pjesë e Indeksit të Hapjes asistojnë në përcaktimin, paraqitjen, dhe vlerësimin e punës dhe vullnetit të mirë politik drejt transparencës.

## **HAPJA E ZYRËS SË KRYEMINISTRIT NË VITIN 2019**

---


Zyra e Kryeministrit shënoi një rezultat të përgjithshëm prej 63% për vitin 2019. Kjo tregon progres krahasuar me rezultatet e viteve të kaluara, megjithatë ka ende hapësirë për përmirësim në krahasim me vendet e tjera nga rajoni si dhe kur flasim në aspekt shtetëror. Kur krahasojmë këtë rezultat me rezultatin prej 53% në vitin 2018 ka një progres të madh të treguar brenda një viti.

## **HAPJA E ZYRËS SË KRYEMINISTRIT NË VITIN 2020**

---

Zyra e Kryeministrit mori një rezultat të përgjithshëm prej 62% për vitin 2020. Institucioni në fjalë duhet të jetë në vazhdimësi edhe më i hapur dhe transparent për publikun dhe palët e treta - kështu duke qenë shembull për institucionet e tjera, siç është linja e ministrive. Zyra e Kryeministrit ka ende shumë hapësirë për përmirësim sidomos në parimin e transparencës sepse në këtë parim ka shënuar 41% për vitin 2020, krahasuar me 51% sa ishte për vitin 2019.

Në pjesën vijuese, do të ketë një shpjegim të hollësishëm të parimeve kryesore dhe rezultatit të zyrës së Kryeministrit në katër parimet për hapjen e qeverisë, të cilat përfshijnë: transparencën, qasshmërinë, integritetin dhe ndërgjegjësimin.





## **TRANSPARENCA (41%)**

Parimi i transparencës për vitin 2020 ka shënuar ulje në krahasim me vitet e kaluara, duke shënuar 41%. Ky parim, ndër të tjera, kërkon që informacioni organizativ, buxheti dhe proceset e prokurimit publik të jenë në dispozicion të publikut dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit.

Uebfaqja zyrtare e Zyrës së Kryeministrit është e përditësuar me përshkrimin e kompetencave të qeverisë, strategjitë dhe procedurat më të fundit, minutat e takimit dhe dokumentet e diskutuara në seancat e Qeverisë. Për më tepër, informacioni i paraqitur në faqen në internet është i disponueshëm në dy gjuhët zyrtare të vendit. Mirëpo, duke vlerësuar përmirësimet në pikat e lartpërmendura, duhet theksuar se mungojnë të dhëna të cilat ndërlidhen me transparenën buxhetore - duke qenë se nuk publikohen informacione dhe raporte kontraktuese, buxhetore dhe as plane financiare. Gjithashtu, nuk ka asnjë informacion në lidhje me nivelin dhe përbërjen e shpenzimeve publike, shërbimin e shpenzimeve dhe menaxhimin e shpenzimeve.

Edhe gjatë këtij viti vlerësimi, informatat mbi procedurat e prokurimit publik, të tilla si: thirrjet e hapura për prokurim, vendimet dhe kontratat mbi prokurimin dhe informacione të tjera, nuk ofrohen nga Zyra e Kryeministrit. Poashtu, Zyra e Kryeministrit nuk ofron një listë për kompanitë e dënuara të ryshfetit në proceset e prokurimit e që do të ndalohehin për pjesëmarrje në ofertat e ardhshme të prokurimit. Sidoqoftë, platforma elektronike E-prokurimi e zhvilluar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik vazhdon të ofrojë informacionet e tilla. Në këtë drejtim, Zyra e Kryeministrit duhet të ofrojë një vegëz të jashtme brenda faqes së saj të internetit që i drejton qytetarët drejt informacionit përkatës, respektivisht drejt platformes E-prokurimi.



## QASSHMËRIA (69%)

Parimi i Qasshmërisë përgjatë këtij viti vlerësimi ka shënuar rritje në 69%, prej 63% sa ishte në vitin paraprak të matur. Ky rezultat, edhe pse tregon progres, tregon gjithashtu se ka hapësirë për përmirësim. Qasshmëria adreson nivelin e qytetarëve, OSHC-ve, dhe akterëve të interesuar për të marrë pjesë në punën e Qeverisë, përfshirë por pa u kufizuar në Aktin e Lirisë së Informacionit dhe rregulloreve të tjera.

Duke iu referuar Ligjit për Qasjen në Dokumente Publike, secili institucion publik detyrohet të ketë një adresë zyrtare të postës elektronike, posaçërisht për komunikim me publikun dhe të ngarkojë një person për të kontrolluar rregullisht të dhënat e pranuar. Ekziston një zbatim praktik i këtij ligji pasi është një person i caktuar që merret me kërkesat për liri të informacionit me një afat kohor minimal të arsyeshëm për të trajtuar kërkesa të tilla. Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për raportet vjetore të qasjes në dokumente publike, ende mungon monitorimi i kërkesave që refuzohen ose mbeten pa përgjigje. Edhe gjatë këtij viti të matjes rekomandohet të funksionalizohet një mekanizëm i cili do të monitoronte kërkesat e pranuar, dhe statusin e atyre kërkesave. Një mekanizëm i tillë do të asistonte Zyrën e Kryeministrit të ishte më i hapur dhe i qasshëm për publikun, kështu duke arritur një rezultat më të lartë për në këtë komponentë të Qasjes.

Edhe në këtë vit vlerësimi duhet theksuar platformën e Konsultimit Publik të zhvilluar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit e cila vazhdon të përditësohet me të gjitha dokumentet e nevojshme për konsultim e që publikohen nga Ministrinë përkatëse. Përveç kësaj, raportet mbi konsultimet publikohen gjithashtu në platformë.

Sa i përket subjekteve shtetërore të tilla si ndërmarrjet, kompanitë publike dhe të tjera, ato ende nuk kanë zbatim në aspektin e së drejtës për t'u qasur në informacion. Asnjë institucion në Kosovë, përfshirë Zyrën e Kryeministrit, nuk ka ofruar ndonjë listë publike ose regjistër të dokumenteve të disponueshme në posedim të tyre për publikun e gjerë, edhe pse kjo është e paraparë me ligj.

Kur vlerësohet qasshmëria e Zyres së Kryeministrit në rrjetet sociale, vlen të theksohet se faqet zyrtare në Facebook dhe Twitter të cilat përfshijnë lajme për Zyren në fjalë janë të publikuara në faqen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kurse llogaritë në rrjetet sociale si Twitter dhe Instagram janë të ndërlidhura me llogarinë e Kryeministrit të vendit, të cilat përditësohen vazhdimisht me lajmet më të fundit. Kjo njëkohësisht lehtëson qasshmërinë dhe njoftimin e publikut të gjerë mbi aktivitetet e Zyrës.

## **INTEGRITETI (96%)**

Përgjatë këtij viti vlerësimi, Zyra e Kryeministrit të Kosovës ka shënuar një vlerësim prej 96% sa i përket parimit të Integritetit i cili adreson parandalimin e korrupsionit, zbatimin e kodit të etikës dhe rregulloret e lobimit.

Ky vlerësim është arritur duke qenë se Institucioni në fjalë vazhdon të monitoroj zbatimin e Kodit të Etikës përmes Agjencisë për Administratën e Nëpunësve Civil. Vazhdimësia e vlerësimit të kënaqshëm në këtë parim është kryesisht edhe nga vlerësimi pozitiv i zbatimit të Kodit të Etikës nga deputetët. Deputetët vazhdojnë të deklarojnë pasurinë e tyre përmes kartave të pasurisë, të cilat publikohen në uebfaqen e Agjencionit Kundër Korrupsionit.

Një tregues të cilin Kosova vazhdon të ngecë është mos-implementimi i rregulloreve për lobistët dhe aktivitetet që ata implementojnë - e të cilat do të rrisnin mbrojtjen e interesit publik. Poashtu, theks më të veçantë duhet ofruar organizimit të trajnimeve dhe punëtorive apo aktiviteteve të tjera edukuese për punonjësit në Zyrën e Kryeministrit, të cilët do të njoftoheshin dhe më shumë rreth temave si: parandalimi i korrupsionit, konflikti i interesit, krijimi i mjeteve sinjalizuese se si të veprohet në rast të shkeljeve/parregullsive etj.





## **NDËRGJEGJËSIMI (71%)**

Në komponentën e fundit të vlerësimit por jo më pak të rëndësishmen, Zyra e Kryeministrit të Kosovës ka shënuar 71%. Komponenta e ndërgjegjësimit adreson mekanizmat e brendshëm që përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar politikat e kryera nga Zyra e Kryeministrit. Duke qenë se është shënuar një ngritje të lehtë në krahasim me vlerësimin e vitit të kaluar ku ka shënuar 70%, dëshmon se Zyra e Kryeministrit ka ende hapësirë për përmirësim.

Kur analizohet nëndomeni i planifikimit strategjik në kuadër të komponentës së ndërgjegjësimit, vlen të theksohet se në Kryeministri zhvillon punën Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS). Kjo zyrë këshillon Kryeministrin dhe Qeverinë për prioritetet strategjike të politikave të Qeverisë, bën koordinimin e procesit të planifikimit strategjik dhe shqyrton dokumentet strategjike, për të siguruar përputhshmërinë në mes tyre dhe me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Sa i përket planeve dhe raporteve vjetore të punës të Qeverisë, ky Institucion vendos në funksion indikator të performancës, mirëpo gjatë këtij viti të matjes nuk kanë qenë të qasshme në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Kryeministrit. Indikatorët e tillë duhet të jenë lehtësisht të qasshme për publikun dhe palët e interesuara sepse janë të rëndësishme për matjen, monitorimin dhe vlerësimin e performancës së Ministrive përkatëse.

Gjithsesi, vlen të theksohet se raportimi i Ministrive vazhdon të jetë konsistent sipas rregullores së punës së Qeverisë së Kosovës, e cila specifikon metodën dhe llojin e informacionit që kërkohet në raportet e ministrisë - e të cilat dërgohen për miratim në Zyrën e Kryeministrit.



## ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË PUNËN E PUSHTETIT EKZEKUTIV NË KOSOVË

ODK ka vazhduar bashkëpunimin me UBO Consulting duke hulumtuar angazhimin dhe mendimet e qytetarëve për punën e Qeverisë së Kosovës. Gjithsej 1065 qytetarë të Republikës së Kosovës janë intervistuar përmes metodës së mostrës gjithëpërfshirëse, të grupuar sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, vendbanimit dhe të ardhurave familjare.

Nga anketat e zhvilluara, më pak përcillet puna e Qeverisë së Kosovës, sesa puna e Kuvendit të Kosovës. Bazuar në të gjeturat e anketës, përqindja e të anketuarve që kanë treguar se ndjekin pak punën e Qeverisë janë 43.8% e femrave dhe 32.0% e meshkujve. Në anën tjetër, puna e Qeverisë së Kosovës nuk përcillet fare nga 22.3% e femrave dhe 16.1% e meshkujve të anketuar, dhe përcillet shumë vetëm nga 3.6% e grave dhe 7.9% e burrave. Këto gjetje mund të nënkuptojnë se puna e Qeverisë nuk arrin të sigurohet në një format të kuptueshëm dhe të arritshëm tek qytetarët.

Pyetja vijuese e cila u adresua ishte sa mendonjnë të anketuarit se vendimet e Qeverisë reflektojnë qëndrimet e tyre. Në përgjithësi, përgjigja më e lartë ishte se të anketuarit nuk mendojnë se vendimet e qeverisë pasqyrojnë qëndrimet e tyre, me 57.1% të grave dhe 62.7% të burrave që e tregojnë këtë. Kurse 23.6% e femrave dhe 27.2% e meshkujve thanë se mendojnë se vendimet e qeverisë pasqyrojnë qëndrimin e tyre, ndërsa 19.3% e femrave dhe 10.2% e meshkujve thanë se nuk kanë një mendim.

Vlen të theksohet se në pyetjen e fundit drejtuar tek të anketuarit, më shumë se gjysma e të anketuarve nuk mendojnë se mund të kontribuojnë në iniciativat e Qeverisë së Kosovës. Kurse vetëm 36.3% e meshkujve, dhe 27.2% e femrave menduan se mund të kontribuojnë në punën e Institucionit në fjalë. Në anën tjetër 17.8% e meshkujve dhe 12.4% e femrave të anketuar rreth kësaj çështje nuk kishin një mendim të caktuar.

Nga këto rezultate duhet theksuar se është me rëndësi përfshierja e bindjeve të qytetarëve në punën e Qeverisë së Kosovës, andaj duhet gjetur dhe punuar në zhvillimin e formave të cilat arrijnë tek qytetari – kështu duke mundësuar dhe llogaritur inputin e qytetarit në punën e Institucionit në fjalë.

## **REKOMANDIME**

### **HAPAT E VEPRIMIT**

Edhe në këtë vit vlerësimi, në mënyrë që të vazhdohet puna e Qeverisë së Kosovës me rezultate të larta, ne rekomandojmë që Qeveria të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- **Të rregullojë rregullat e lobimit me ligj;**
- **Të krijohet forma e ankesave në uebfaqen zyrtare të Zyres së Kryeministrit duke siguruar informacione për kronologjinë, nëpunësit civilë përkatës dhe institucionet që merren direkt me ankesat/ kërkesat specifike;**
- **Të publikoj indikatorët e performancës për Ministritë përkatëse, sepse janë të rëndësishme për matjen, monitorimin dhe vlerësimin e performancës së institucioneve në fjalë;**
- **Të publikojë në uebfaqen zyrtare të internetit transmetimet audio dhe/ose video të seancave të Qeverisë;**
- **Të publikojë një plan integriteti ose politikë të brendshme kundër korrupsionit, duke përfshirë masa për parandalimin e formave të ndryshme të korrupsionit dhe sjelljes joetike brenda institucionit;**
- **Të publikojë pagat e zyrtarëve publikë në uebfaqe;**
- **Të publikojë raporte të shpenzimeve në uebfaqën e internetit;**
- **Të sigurojë një listë që kompanitë e dënuara të ryshfetit të ndalohen të marrin pjesë në ofertat e ardhshme të prokurimit.**

